VENDIM
Nr. 1103, datë 24.12.2020

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "MUZEU HEBRAIK SHQIPTAR NË VLORË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Muzeu Hebraik Shqiptar në Vlorë", në zbatim të vendimit nr. 218, datë 21.7.2020, të KKTKM-së, "Për miratimin e propozimit paraprak për zhvillimin e 'Muzeut Hebraik Shqiptar në Vlorë'", dhe të vendimit nr. 1, datë 23.7.2020, të Këshillit Kombëtar të Muzeve, "Për miratimin e projektidesë së muzealizimit të 'Muzeut Hebraik Shqiptar në Vlorë'".
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë.
3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "apartament", me një vlerë të përgjithshme prej 6 737 363 (gjashtë milionë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 6 737 363 (gjashtë milionë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) lekësh, do të përballohet nga buxheti i vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Kulturës, zëri "shpronësime".
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Ministria e Kulturës.
6. Shpronësimi të fillojë menjëherë nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Drejtorisë Rajonale së Trashëgimisë Kulturore Vlorë.
8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës Vlorë, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes se gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit, Drejtorisë Rajonale së Trashëgimisë Kulturore Vlorë, për pasurinë e shpronësuar.
9. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës Vlorë, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA PARAPRAKE ME EMRAT E PRONARËVE PËR PASURITË E PALUAJTSHME QË PREKEN NGA PROJEKTI "MUZEU HEBRAIK SHQIPTAR NË VLORË" (PROJEKTPROPOZIM PARAPRAK ENDE I PAMIRATUAR)

Zona kadastrale 8601 (pasuritë e paluajtshme dhe çmimi mesatar i shitblerjeve për tre muajt e fundit, sipas konfirmimit të dërguar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës me shkresën nr. 7730/1, prot. , datë 29.9.2020 dhe shkresën me nr. 8713/2 prot., datë 11.11.2020.

Zona kadastrale	**Nr. i pasurisë**	**Adresa**	**Pronari**	**Sipërfaqe trualli**	**Sipërfaqe ndërtimi**	**Çmimi i truallit, lek/m²**	**Çmimi i ndërtimit lek/m²**	**Vlera e Truallit, lek**	**Vlera e ndërtimit, lek**	**Vlera truall dhe ndërtesë**	**Shënime**
8601	20/2+1-1	Vlorë	Ernest Sefedin Tozaj	-	58.8	-	55,133.9	-	3.241.873.3	-	Konfirmuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës
8601	20/2	Vlorë	Mariban Korabi	-		-	55,133.9	-	00	-	E pakonfirmuar sipërfaqja (referuar shkresës së ASHK-së nr. 7730/1 prot., datë 29.9.2020
8601	20/2	Vlorë	Gjergji Korabi	-	63.4	-	55,133.9	-	3.495.489.3	-	E pakonfirmuar sipërfaqja (referuar shkresës së ASHK-së nr. 7730/1 prot., datë 29.9.2020